



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

1092/20

Datë/Datum.

12.01.21

PRISHTINE - PRISTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.1092/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Blerim Dina - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Goran Milenkovic - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik “Triangle” SH.P.K & “Globi-Mi” SH.P.K-Suharekë, kundër B58 - njoftimit mbi vendimin e AK-së (vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Projekt me bashkëfinancim –Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqeve në fshatrat e Komunës së Suharekës” me nr. të prokurimit: 624-20-2918-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Suharekë”, më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “Triangle” SH.P.K & “Globi-Mi” SH.P.K-Suharekë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Projekt me bashkëfinancim –Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqeve në fshatrat e Komunës së Suharekës” me nr. të prokurimit: 624-20-2918-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Suharekë”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për anulim i AK-së për aktivitetin e prokurimit me titull “Projekt me bashkëfinancim –Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqeve në fshatrat e Komunës së Suharekës” me nr. të prokurimit: 624-20-2918-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Suharekë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik ankues “Triangle” SH.P.K & “Globi-Mi” SH.P.K-Suharekë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik ankues “Triangle” SH.P.K & “Globi-Mi” SH.P.K-Suharekë, si palë e pa kënaqur kanë deponuar ankesë në OSHP, me 14.12.2020 me nr. 1092/20, kundër B58 - njoftimit mbi vendimin e AK-së (vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Projekt me bashkëfinancim –Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqeve në fshatrat e Komunës së Suharekës” me nr. të prokurimit: 624-20-2918-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-“KK-Suharekë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 9, 22, 59, 60 dhe 62 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 8 dhe 44.5 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 15.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 18.12.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK-së ka shkelur nenin 1, 7, 59, dhe 60 të LLP-së. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, përgjigjeve të pranuar nga AK - ZPP lidhur me sqarimet e kërkuar nga ESH përmes e-mail të datës 16.12.2020, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK me datë 13.04.2020 ka nënshkruar marrëveshje për këtë projekt me MAPL-në lidhur me përfitimin nga skema e grantit për përfitime komunale, kurse publikimin e njoftimit për kontratë

dhe dosjen e tenderit ka publikuar ne platformën elektronike e-prokurim me date 16.06.2020, kurse procesverbali i hapës është bere me date 08.07.2020, janë nxjerr dy vendime nga PSH lidhur me këtë aktivitet te prokurimit duke kthyer ne rivlerësim pasi qe AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore te LPP, ku OE ankues ka qene palë e ankese ne vazhdimësi, prandaj bazuar në Rregulloren e Punës Nr. 01/2020 te datës 03.03.2020 Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit e ndryshuar plotësuar me datën 08.10.2020, bazuar ne neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore te njëjta për palët ne procedurë lidhur me këto pretendime ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, për rastet te cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 te LPP-së, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenin 9, 22, dhe 62 te LPP-së, si dhe nenin 8 dhe 44.5 te RRUOPP-së Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne B58 - njoftimi mbi vendimin e AK (anulimin e këtij aktivitet te prokurimit), vendimit mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 10.12.2020 nga zyrtari përgjegjës i prokurimit, po ashtu duke marr për bazë Vendimin e Qeverise nr. 01/46 te datës 25.11.2020, e-mail-in dërguar nga zyrtaret e MAPL, ku thotë: “Bazuar në vendimin e qeverisë nr. 01/46 të datës 25.11.2020 për kursime buxhetore, ju njoftojmë se projekti i financuar në komunën e juaj sipas marrëveshjes së mirëkuptimit të datës 24.04.2020 “Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqe në fshatrat e komunës” në vlerë prej 231,956.22€, është pjesë e këtij vendimi për kursime buxhetore, pra këto mjete nuk janë më pjesë e buxhetit të Ministrisë së Pushtetit Lokal”, duke i marr për bazë gjithë dokumentet, si dhe bazuar ne nenin 26 par. 4.2 te LPP-së, po citoj: “personat kanë konfirmuar edhe një herë se informatat që gjinden në “Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve” janë ende të sakta;”, andaj bazuar ne te gjithë e këto dokumente mjetet financiar te parapara për këtë projekt, tani nuk janë pjese e buxhetit te MAPL, prandaj ky aktivitet i prokurimit, është anuluar ne pajtim me paragrafët e nenit 62 të LPP-së, ku thuhet: 1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një shkeljeje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit”, si dhe AK - ZPP ka vepruar ne pajtim me nenin 44.5 të RRUOPP-së, po citoj: “- *Procedura e prokurimit* pas hapjes së ofertave, duhet të anulohet për një nga arsyet e më poshtme: (ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të

parandalohet përmes një ndryshimi;”. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe rekomandon të mbetet ne fuqi vendimi B58 - njoftimit mbi vendimin AK (anulimi i aktivitetit te prokurimit).

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18.12.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 21.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: “Triangle”SH.P.K & “Globi-Mi”SH.P.K-Suharekë, me datë: 22.12.2020, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar ne me datën 18.12.2020 kemi pranuar ne email mendimin e ekspertit me te cilin nuk pajtohemi, ne si kompani jemi te dëmtuar shume për këtë projekt, pasi qe kemi angazhuar ekspert si dhe na është humbur shume kohe te cilën kohe vet AK e ka zvarritur vetëm te vije deri ne fund vite, pas vendimit te par te OSHP-se ne si kompani kemi menduar qe do te jemi fitues te këtij projekti dhe kemi lan anash dorëzimin e ofertave tjera duke e pasur te gjithë fokusin ne këtë projekt. Po ashtu pas shpalljes fitues me datën 27.11.2020 ne si kompani kemi ber një mobilizim, kemi filluar edhe me porosinë e disa materialeve ne mënyrë qe te kemi një dinamik ne ekzekutimin e punimeve, lusim panelin shqyrtues qe te vlerësoj ne mënyrë te drejt situatën dhe te i sheh te gjitha faktet dhe argumentet qe vet AK ka qen fajtor për zvarritjen e procedurave te tenderit ku haptas nuk e ka respektuar edhe një vendim te OSHP-se 592,613/20 prandaj shto këtu edhe pandeminë kompania jone është e dëmtuar shume si ne aspekt kohor po ashtu edhe ne atë financiar. Për fund edhe një herë po ua rikujtojmë: AK-së në fillim me dt. 13.08.2020 e keni nënshkruar edhe deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve konform nenit 9 të LPP-së, ndërsa në këtë dispozitë shkruan: “Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues”. Pra AK si autoritet kontraktues kanë qenë të obliguar me ligj, që nga fillimi ti ndjekin hapat dhe proceset e prokurimit, e jo të veproni në mënyrë subjektive dhe diskriminuese duke e anuluar aktivitetin në fjalë.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e

dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK-së ka shkelur nenin 1, 7, 59, dhe 60 të LLP-së. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, përgjigjeve të pranuar nga AK - ZPP lidhur me sqarimet e kërkuar nga eksperti shqyrtues përmes e-mail të datës 16.12.2020, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK me datë 13.04.2020 ka nënshkruar marrëveshje për këtë projekt me MAPL-në lidhur me përfitimin nga skema e grantit për përfitime komunale, kurse publikimin e njoftimit për kontratë dhe dosjen e tenderit e ka publikuar në platformën elektronike e-prokurim me datë 16.06.2020, kurse procesverbali i hapjes është bërë me datë 08.07.2020, janë nxjerr dy vendime nga PSH lidhur me këtë aktivitet të prokurimit duke kthyer në rivlerësim pasi që AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, ku OE ankues ka qenë palë ankuese në vazhdimësi. Prandaj, bazuar në Rregulloren e Punës Nr. 01/2020 të datës 03.03.2020 Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit e ndryshuar plotësuar me datën 08.10.2020, bazuar në neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontestit dhe palët janë të njëjta, për rastet të cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje të gjykuara “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së, andaj nuk janë trajtuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenin 9, 22, dhe 62 të LPP-së, si dhe nenin 8 dhe 44.5 të RRUOPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në B58 - njoftimi mbi vendimin e AK (anulimin e këtij aktivitet të prokurimit), vendimit mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 10.12.2020 nga zyrtari përgjegjës i prokurimit, po ashtu duke marrë për bazë Vendimin e Qeverisë nr. 01/46 të datës 25.11.2020, e-mail-in dërguar nga zyrtaret e MAPL, ku thotë: “Bazuar në vendimin e qeverisë nr. 01/46 të datës 25.11.2020 për kursime buxhetore, ju njoftojmë se projekti i financuar në komunën e juaj sipas marrëveshjes së mirëkuptimit të datës 24.04.2020 “Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqe në fshatrat e komunës” në vlerë prej 231,956.22€, është pjesë e këtij vendimi për kursime buxhetore, pra këto mjete nuk janë më pjesë e buxhetit të Ministrisë së Pushtetit Lokal”. Duke i marrë për bazë gjithë dokumentet, si dhe bazuar në nenin 26 par. 4.2 të LPP-së, ku thuhet: “personat kanë konfirmuar edhe një

herë se informatat që gjinden në “Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve” janë ende të sakta;”. Andaj, bazuar në gjithë këtë, mjetet financiar të parapara për këtë projekt tani nuk janë pjesë e buxhetit të MAPL-së. Prandaj, ky aktivitet i prokurimit është anuluar në pajtim me paragrafët e nenit 62 të LPP-së, ku thuhet: 1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një shkeljeje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit”, si dhe AK - ZPP ka vepruar në pajtim me nenin 44.5 të RRUOPP-së, ku thuhet: “- *Procedura e prokurimit* pas hapjes së ofertave, duhet të anulohet për një nga arsyet e më poshtme: (ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;”.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, vjen në përfundim se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit nga AK është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së për arsyet e cekura si më lartë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t’i dorëzohet:

- 1x1 AK “KK-Suharekë”;
- 1x1 OE “Triangle”SH.P.K & “Globi-Mi”SH.P.K-Suharekë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.